VENDIM
Nr. 359, datë 11.5.2016

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI – TEMA: NDËRTESAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2/l dhe 16, pika 1, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeo-hapësinor në Republikën e Shqipërisë", me pro-pozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – Tema: Ndërtesat", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autori-tetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. PËRSHKRIM MBI STANDARDIN

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në Direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe në bashkëpunim me INSTAT, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ZQRPP dhe ALUIZNI-n. Data e publikimit të versionit Nr.1 është Tetor 2015. Emërtimi i dokumetit është: ASIG_Standard_NSDI_2015_BU_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit
Standard – Lloji i dokumentit
NSDI – Qëllimi i dokumentit
2015 – Viti i krijimit
ND – Tema për të cilën është krijuar standardi
v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. SI LEXOHET KY DOKUMENT

Ky material është i strukturuar në katër kapituj kryesorë:

1- **Përshkrim mbi standardet** – Në këtë pjesë jepen emërtimi dhe autori i standardeve.
2- **Hyrje** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të kuptohet më lehtë.
3- **Tema** – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për secilën temë.
4- **Anekse** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë shpjeguese në ndihmë të lexuesve.

Përmbajtja e Kapitullit 3 është strukturuar në 6 pjesë kryesore:

1- **Përshkrimi i temës** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës.
2- **Diagramat UML** – Përmbajtja e Katalogut të Tipologjive përkthyer sipas gjuhës UML.
3- **Katalogu i Tipologjive** – Këtu shpjegohet struktura e temës me të gjithë elementët e saj përbërës.
4- **Metadata** – Këtu jepen specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.
5- **Sistemi koordinativ referencë** – Në këtë nën kapitull pëcaktohet sistemi koordinativ referencë që është miratuar sipas vendimit Nr. 669 datë 7/8/2013 .
6- **Cilësia e të dhënave** – Jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementëve dhe matjes së tyre.

Diagramat UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementët kryesorë të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit hapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në Katalogun e Tipologjive (Feature Catalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike por nuk janë të familjarizuar me UML-në mund ta kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke u fokusuar tek Katalogu i Tipologjive. Për përdoruesit, Katalogu i Tipologjive mund të jetë veçanërisht i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhënat e nevojshme për aplikacionet që ata përdorin.

Në tabelat e mëposhtme jepet një shpjegim mbi përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e Tipologjive.

Tabela Nr.1, 2, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela Nr.3, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kod listës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi:	Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi:	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Tipi i tipologjisë	**Tipi i elementit** i cili mund të jetë i këtyre llojeve: **«featureType»** - një element i cili mund të jetë real në terren apo një fenomen abstrakt **«dataType»** - një element tabelor i cili shërben vetëm si tabelë atributesh për tu lidhur me një element tjetër. Në document gjendet e shipëruar si 'tipet e të dhënave' **«enumeration»** **«codeList»** - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. Enumeration nënkupton "renditje vlerash", ndërsa codeList nënkupton "listë vlerash ose ndryshe kod listë". Në dokument gjenden e shqipëruara 'Numërtimet dhe kod listat' **«Imported»** - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në document gjendet e shipëruar si 'Të dhënat e importuara'
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tre forma: **pikë, linjë ose polygon.** **Abstrakt** – kur elementi nuk është element real në terren por konsiderohet vetëm si fenomen.
Shumëllojshmëria:	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimum 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
Detyrueshme	Po – nëse atributi është i detyrueshem të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Lidhjet	Në tabelën e lidhjeve "Associations" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementëve të ndryshëm në këtë temë po ashtu dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- Emri -- Emërtimi i atributit. **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve. **-- Përshkrimi --** Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin. [Detyrueshme : Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme p.sh: ***Ligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës. **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktives INSPIRE të elementëve.
Vlera e dytë (etj) e listës së gatshme p.sh: ***Jo Ligjor*** **-- Emri --** Emërtimi i vlerës. **-- Përkufizimi --** Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve.

Gjeometria

- Të dhëna 2D

Gjeometria e tipologjive paraqitet në hapësirë dy dimensionale. Kjo do të thotë që gjeometria dy dimensionale jepet nëpërmjet koordinatave (X,Y).

Figura 1



- Të dhëna 2.5D

Gjeometria e tipologjive paraqitet në hapësirë tre dimensionale me detyrimin që, për çdo vendndodhje (X,Y), ekziston vetëm një Z.



Figura 2

- Të dhëna 3D

Gjeometria e tipologjive paraqitet në hapësirë tre dimensionale nëpërmjet koordinatave (X,Y,Z).



Figura 3

- Komponentë të ndërtesave

Çdo nën ndarje apo element i ndërtesës, psh mur, çati, dhomë.

Karakteristikat e <<voidable>> dhe shumëllojshmëria.

Stereotipi <<*voidable*>> përdoret për të përshkruar ato përkatësi të objekteve hapësinore të cilat mund të jenë ose mund të mos jenë prezente në grupet e të dhënave hapësinore, edhe pse ato mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet ti jepet një vlerë.

Për të gjitha përkatësitë e përcaktuara për objektet hapësinore duhet te paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave) ose vlera '*void*'. Një vlerë *void* nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave hapësinore që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese me kosto të arsyeshme.

Arsyeja e përdorjes së vlerës void duhet të paraqitet kurdo të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kod listen VleraEArsyesSëPavlefshmërisë (VoidReasonValue).

Stereotipi <<voidable>> nuk jep informacion nëse karakteristika ekziston ose jo në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristike mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. Psh nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. Psh nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

Llojet e kod listave (Enumeration and CodeList)

Kod listat modelohen si klasa në skemat e aplikimit por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit. Në kod listë, 'vlera të tjera' përcakton llojin e përmbajtjes së kod listës përcaktuar specifikisht si më poshtë:

'jo' përfaqëson kod lista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë rregullore.

't**ë **kufizuara' përfaqëson kod lista të përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

't**ë **hapura' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera shtesë në çdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'po' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvëndësojnë apo modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në rregullore.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kod lista me vlera ***jo*** të përmbajtura në rregullore, ofruesit janë të detyruar ti bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që dhe përdoruesit e tjerë t'i kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

Paraqitja e aspektit kohor

Skemat e aplikimit përdorin atributin "FillimiIJetegjatesise" dhe "MbarimiIJetegjatesise" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti hapësinor.

Atributi "FillimiIJetegjatesise" specifikon datën kur versioni i objektit hapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave hapësinore (në sistem). Atributi "MbarimiIJetegjatesise" specifikon datën kur versioni i objektit

hapësinor është zëvëndësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave hapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "MbarimiIJetegjatesise" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "FillimiIJetegjatesise".

❖ Shënim i rëndësishëm:
Disa terma në katalogun e tipologjive si p.sh: tipi i tipologjisë, etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën Shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasë kuptimi gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.2. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit Nr 72/2012, neni 16, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet europiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të implementojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave.

Standardet (Rregullat e Implementimit (IR)) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet sesi metadata-t duhen të jenë. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjithë institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do implementojnë këtë direktive.

- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme të cilat do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute si bazë e cila do të shërbejë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose nevojave të brendshme mund të shtojnë atribute të tjera, për ti bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjithë të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të aprovuara nga institucionet përgjegjëse lokale.

2.3. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompani private apo individët, të cilët mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të Institucioneve Publike, janë të detyruar ti nënshtrohen kësaj rregulloreje.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:



Figura 4

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do jetë çertifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat për tu përshtatur me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe manipulohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuar gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi, janë bashkësi të dhënash të cilat janë gati për tu publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (Qytetarët, Autoritetet publike, Organizatat ose Palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, përdorë, analizojë ose të citojë ato. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është proces i vazhdueshëm mbi të dhënat e publikuara, gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jo cilësore.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi cfarë do bëhet më të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces regjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit, bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultati i këtij procesi janë të dhënat të cilat bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose standarde specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit, të dhënat bëhen të pa rikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1. NDËRTESAT

3.1.1. PËRSHKRIMI I TEMËS

Të dhënat mbi ndërtesat janë temë kryesore për studimet mjedisore. Ndërtesat janë vendi ku njerzit jetojnë, punojnë dhe kalojnë pjesën më të madhe të kohës dhe ku duhet t'ju sigurohen kushte të mira jetese dhe mbrojtjeje ndaj rreziqeve (përmbytjeve, zjarrit, tërmeteve etj) dhe ndotjeve (zhurmat, ndotja e ajrit etj). Ndërtesat në vetvete mund të meritojnë mbrojtje për shkak të rëndësisë historike apo arkitekturore. Në të njejtën kohë, ndërtesat dhe banuesit konsumojnë resurset natyrore (ngrohjen, tokën, materialet e ndërtimit) dhe është dukshëm e nevojshme të promovohen ndërtesat e qëndrueshme dhe të kontrollohet përhapja urbane. Ky specifikim të dhënash adreson kërkesa të lidhura me raportimet Europiane si Direktiva e Zhurmave, Direktiva e Cilësisë së Ajrit, Direktiva e Përformancës së Energjisë së Ndërtesave dhe Direktiva e Popullsisë dhe Regjistrimit të Banesave. Direktiva e Përmbytjeve dhe projekti për Direktivën e Tokës janë marrë gjithashtu në konsideratë.

Për më tepër, tema "*Ndërtesat*" është pjesë e të dhënave referencë që kërkohen në Infrastrukturën e të Dhënave Hapësinore për të përshkruar peisazhin dhe për shumë aplikime hartash dhe komunikim. Vecanërisht, disa ndërtesa dhe konstruksione përbëjnë pika referimi të rëndësishme për udhëtarët.

Nën fushëveprimin e temës Ndërtesat konsiderohen ndërtime mbi ose/dhe nëntokë të cilat janë të destinuara për përdorim ose përdoren për strehimin e njerëzve, kafshëve, mallrave dhe për prodhimin e mallrave apo ofrimin e shërbimeve dhe që i referohen çdo strukture të ndërtuar.

Ky specifikim të dhënash në lidhje me ndërtesat adreson rastet me nivel të lartë përdorimi, ilustruar në figurën më poshtë. Në vecanti, ky specifikim të dhënash adreson Direktivën e Zhurmave, Direktivën e Cilësisë së Ajrit, Direktivën e Përformancës së Energjisë së Ndërtesave dhe Direktivën e Popullsisë dhe Regjistrimit të Banesave. Direktiva e Përmbytjeve dhe projekti për Direktivën e Tokës janë marrë gjithashtu në konsideratë.



Të dhënat dhe standardet ekzistuese

Ka shumë grupe të dhënash që përshkruajnë karakteristika të lidhura me ndërtimet. Këto grupe të dhënash janë kryesisht të prodhuara nga organizata shtetërore të mirë identifikuara, përgjithësisht agjensi kombëtare kadastrale dhe hartografike.

Të dhënat e ndërtesave ekzistojnë në nivele të ndryshme detajimi si në gjeometri edhe në semantikë. Paraqitja e sipërfaqes 2D është më e shpeshta duke përdorur njollën e ndërtimit apo perimetrin e çatisë. Paraqitja 3D realizohet duke përdorur nivele detajimi të mirë përcaktuara në standardin CityGML OGC.

Të gjitha këto paraqitje të ndryshme kanë dobitë dhe limitet e tyre. Për shembull, të dhënat 3D ofrojnë një mjet të mrekullueshëm për të hartuar dhe komunikuar me projektet e urbanizimit por janë larg të qënit të pranueshme nga çdo lloj softëare-i. Një tjetër shembull është niveli i detajimit të paraqitjes gjeometrike, ndonëse gjeometria e detajuar e ndërtesave mund të jetë e nevojshme për përdorim lokal, një gjeometri më e përgjithësuar, që nënkupton vëllim të dhënash më të vogël dhe për rrjedhojë kohë procesimi më të shkurtër, është më e përshtatshme për fusha më të gjëra interesi.

Specifikimet e të dhënave janë bazuar në disa standarde të cilat mund të klasifikohen si fjalorë, klasifikime dhe modele të dhënash:

- Fjalorë

Standardi ISO 6707 (Building and Civil Engineering)

Standardi DFDD (DGIËG Feature Data Dictionary) është standard i hartuar nga komuniteti ushtarak (DËIËG: Defence Geospatial Information Ëorking Group); ai ofron terminologji dhe përkufizime për tipologjitë topografike, përfshi ndërtesat.

Kodi i matjes CLGE (Council of European Geodetic Surveyors) për sipërfaqen e njollës së ndërtesave ka ofruar referenca për sipërfaqen zyrtare të objekteve.

- Klasifikime

Eurostat ka një klasifikim hierarkik të llojeve të ndërtimeve në varësi të aktivitetit që ushtrohet nga objekti.

- Modelet e të dhënave

LADM (Land Administration Domain Model) është draft standardi ISO 19512. Është një bazë për zhvillimin efikas të sistemit të kadastrës bazuar në Model Driven Architecture. Ai ofron një pikëpamje kadastrale mbi ndërtesat.

CityGML është një standard OGC për paraqitjen e modeleve 3D të qyteteve, përfshi ndërtesat. CityGML ofron nivele të ndryshme detajimi (LoD) për modelimin e ndërtesave:

LoD 0 ofron një model 2D të ndërtesës.

LoD 1 me bllok volumetrik (cati të sheshtë)

LoD 2 me formë catije

LoD 3 me përshkrim të saktë të eksterierit (përfshire carjet: dyer dhe dritare)

LoD 4 me model interieri

Gjenden dhe dy standarde të tjera që merren me përdorime shumë specifike të ndërtesave si:

Aneksi 15 i ICAO (International Civil Aviation Organisation) ofron modele të dhënash për struktura vertikale (përfshi ndërtesat) të quajtura AIXM (Aeronautical Information eXchange Model).

IHO (International Hydrographic Organisation) ka standardin S-57 i cili përmban specifikime të ENC (Electronic Navigation Charts) dhe një fjalor. Të dyja përmbajnë informacion lidhur me temën e ndërtesave.

Aspekti semantik

Është bërë një grumbullim i kërkesave të ndryshme dhe të shumta të përdoruesve. Meqënëse është e pamundur të realizohet një harmonizim i të dhënave në nivel europian për të gjitha këto kërkesa, ky specifikim të dhënash ka përcaktuar disa prioritete ilustruar në imazhin e mëposhtëm:



Figura 5 Hierarkia e semantikës së kërkesave të përdoruesit (featureType) janë paraqitur me ngjyra të ndëzuara ndërsa përkatësitë e tyre me ngjyra më të celta

Harmonizimi është konsideruar i përshtatshëm në nivel Europian kur ai është i bazuar në raste përdorimi Ndërkombëtare apo Europiane dhe kur nuk pritet të ketë probleme të rëndësishme realizueshmërie.

Harmonizimi është konsideruar i përshtatshëm në nivel kombëtar/lokal kur ai është i bazuar vetëm në nivel kombëtar/lokal dhe/ose pritet të ketë probleme realizueshmërie (psh të dhëna zyrtare në varësi të rregulloreve kombëtare, probleme privatësie, mungesë dakordësie në lidhje me qëllimin e temës së ndërtesave).

Bazuar në këtë klasifikim, në këtë specifikim të dhënash janë propozuar dy lloj profilesh semantike:

- Profili normativ bazë – bazuar në të dhëna gjërësisht të përdorura, gjërësisht të disponueshme dhe harmonizimi i të cilave kërkohet në nivel Europian psh për raportime në Direktivat Mjedisore.

- Profili informativ i zgjeruar – bazuar në të dhëna gjërësisht të kërkuara, harmonizimi i të cilave nuk është lehtësisht i arritshëm në afate të shkurtra kohore (psh të dhëna që janë rrallë të disponueshme apo të dhëna harmonizimi i të cilave mund/duhet të bëhet në nivel kombëtar.

Profili normativ bazë përfshin të dhëna topografike themelore (si lartësia, numri i kateve, natyra e objektit, data e ndërtimit etj) dhe të dhëna zyrtare më të zgjeruara (si përdorimi aktual, numri i njësive të banimit etj). Në figurën e mësipërme profili bazë përmban konceptet e shënuara me jeshile.

Profili informativ i zgjeruar përfshin informacion më të detajuar në lidhje me ndërtesat. Ai bazohet në konceptet e shënuara me rozë në figurën e mësipërme.

Modeli i të dhënave dhe profilet

Modeli i të dhënave ofron një qasje fleksibël duke lejuar paraqitje të shumfishta të ndërtesave dhe konstruksioneve.

Feature types janë të paraqitura me ngjyrë blu. *Abstract application schemas* janë të paraqitura me ngjyrë jeshile. *Instantiable application schemas* janë të paraqitura me ngjyrë të kuqe.

Prodhuesit e të dhënave mund të zgjerojnë profilet e standardit me informacione shtesë jo të përfshira në këtë specifikim të dhënash, me kusht që të respektojnë rregullat e paraqitura në GML.



Figura 6 Profilet në modelin e të dhënave

Profili NdërtesatBaza përmban kërkesat që duhet të përfshihen në Rregullat e Implementimit. Ai përmban lloje tipologjish të ndërtesave, të pjesëve të ndërtesave dhe një grup të limituar atributesh kryesisht të lidhura me aspektin kohor (data ndërtimi, rinovimi dhe prishje), informacion fizik (lartësi, numër katesh, kuota) dhe klasifikimin e ndërtesës sipas aspektit fizik dhe përdorimit aktual.

Profili Ndërtesat2D përfshin paraqitje të ndryshme gjeometrike të ndërtesave si të dhëna 2D ose 2.5D.

Profili Ndërtesat3D ka të njëjtën përmbajtje semantike si profili **Ndërtesat2D** dhe për më tepër lejon paraqitjen gjeometrike të ndërtesës në një nga katër nivelet e detajimit të City GML.

Profilet e zgjeruara përmbajnë rekomandime për të siguruar informacion më të detajuar për temën e ndërtesave. Krahas ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave, tipologjitë e tjera të paraqitura janë konstruksione, njësi ndërtimi dhe instalime.

Profili NdertesatBazeEZgjeruar përshkruan semantika shtesë që duhet të përdoren për të zgjeruar profilin normativ, pavarësisht paraqitjes gjeometrike të zgjedhur (2D apo 3D).

Profili Ndërtesat2DEZgjeruar është një zgjerim semantik i **Ndërtesat2D** me atribute tematike shtesë (materiale ndërtimi, sipërfaqe dhe vlera zyrtare, lidhja me rrjetet etj), kategori (njësi ndërtimi, instalime, konstruksione të tjera) dhe të dhëna të tjera referencë (të dhëna kadastrale dhe adresa).

Profili Ndërtesat3DEZgjeruar është një zgjerim i **Ndërtesat3D** për paraqitje 3D të pasuruar në nivele të ndryshme detajimi. Këtu përfshihet mundësia për të paraqitur shumë komponentë si kufirin e ndërtimit (mure, cati…), carjet (dyer – dritare) dhe interierin e ndërtesës (dhomat, instalimet e brendshme) si dhe teksturat e lidhura me llojet e tipologjive kryesore. Ky profil përmban gjithashtu gjithë informacionin semantik të profilit **Ndërtesat2DEZgjeruar.**



Figura 7 Përmbajtja dhe struktura e skemës së aplikimit për temën Ndërtesat

Shtrirja modulare



Figura 8 Qasja modulare për shtrirjen e temës Ndërtesat

Meqënëse ekzistojnë ndërtesa të llojeve dhe madhësive të ndryshme, në mënyrë të ngjashme me qasjen modulare caktuar për nivelet e informacionit, ky specifikim përcakton tre nivele prioriteti në lidhje me shtrirjen e temës:

Prioriteti i parë, të dhënat që do të jenë në standardin teknik përfshijnë:

- Ndërtesat tipike janë ndërtesat e konsideruara të tilla nga çdokush (që përshtaten me të gjitha përkufizimet e ndryshme të ndërtesave); përgjithësisht përmbajnë aktivitete njerëzore (banim, shërbime, tregti etj) dhe kanë përmasa mesatare ose të mëdha (mbi 15-20m^2). Këto lloj ndërtesash tipike janë më tepër në vëmendje të rasteve të përdorimit si psh për regjistrimet, planifikimin hapësinor, modelimin e fenomeneve fizike, vlërësimin e popullsisë në një zonë të caktuar interesi etj. Shembuj tipikë të këtyre ndërtesave janë shtëpitë, blloqet e banesave, fabrikat, supermarketet etj.

- Ndërtesat specifike (të rëndësishme) janë ndërtesa të madhësive dhe lartësive të konsiderueshme me aspekte të vecanta fizike që i bëjnë ato të përdorshme si pika referimi dhe kërkohen nga raste përdorimi si krijimi i hartave turistike, hartave të udhëtimit etj. Shembuj tipikë të këtyre ndërtesave janë kullat, stadiumet, kishat etj.

Prioriteti i dytë, të dhënat që duhet të jenë në standardin teknik përfshijnë:

- Ndërtesat jo tipike përputhen vetëm pjesërisht me përkufizimet e ndërtesave. Ato janë ndërtesa pjesërisht të ndërtuara si psh strehime të nëndheshme, parkime, stacione etj. Këto ndërtesa janë të nevojshme dhe kërkohen nga raste përdorimi si regjistrimet, studimet mbi habitatet e pasigurta, cënushemëria nga rreziku etj.

- Ndërtesat ndihmëse/suporti janë ndërtesa të vogla (rreth 10m^2) që përdoren vetëm në lidhje me një ndërtesë tjetër më të madhe. Si të tilla klasifikohen garazhdet apo strehat e oborreve pranë shtëpive. Këto ndërtesa ndihmëse mund të ndikojnë në përdorimin e tokës / mbulesës së tokës.

- Konstruksionet e tjera përfshijnë konstruksione të kërkuara nga rastet e përdorimit të marra në konsideratë nga ky specifikim të dhënash. Shembuj tipikë në këtë kategori janë muret e qyteteve, urat, oxhaqet, barrierat akustike etj.

Prioriteti i fundit, të dhënat që mund të jenë në standardin teknik përfshijnë të gjitha ndërtesat dhe konstruksionet e tjera, kryesisht ato shumë të vogla (1 apo 2m^2) si kabina telefonike, statuja etj. Këto ndërtesa apo konstruksione mund të jenë të nevojshme në nivel lokal për menaxhimin e aseteve, mbrojtjen e trashëgimisë etj.

Lidhja dhe mbivendosja me temat e tjera

Tema "Ndërtesat" ka mbivendosje me tema të tjera që kanë lidhje me shërbimet qeveritare, industrinë, bujqësinë, transportin, shërbimet hidrografike dhe emërtesat gjeografike.

Disa ndërtesa dhe konstruksione të përfshira në temën "Ndërtesat" janë gjithashtu pjesë e temave të tjera, më së tepërmi shërbimeve (psh një ndërtesë mund të përmbajë një shkollë, burg, spital apo të jetë pjesë e një fabrike). Parimi i përgjithshëm është se për të njëjtat objekte, tema "Ndërtesat" fokusohet në aspektin fizik/topografik ndërsa shërbimet fokusohen në aspektin funksional të objektit.



Figura 9 Lidhja dhe mbivendosja mes Ndërtesave dhe temave të tjera të INSPIRE

3.1.2. DIAGRAMAT UML

3.1.2.1. NDËRTESAT BAZA



Figura 10 Skema e aplikimit bazë

3.1.2.2. NDËRTESAT 2D



Figura 11 - Skema e aplikimit 2D

3.1.2.3. NDËRTESAT 3D



Figura 12 - Skema e aplikimit 3D

3.1.2.4. TIPET E TË DHËNAVE



Figura 13 - Data Types

3.1.2.5. NUMËRTIMI DHE KOD LISTAT.



Figura 14 Enumetation and Code Lists

3.1.3. KATALOGU I TIPOLOGJIVE

3.1.3.1. KATALOGU – BAZA

Sipas konceptit të CityGML, një ndërtesë komplekse mund të konsiderohet si një agregim i disa PjesëNdërtese, sic tregohet në ilustrimin e mëposhtëm:

PjesëNdërtese përdoret për ndërtesa të cilat nuk janë homogjene lidhur me atribute që kanë të bëjnë me aspekte fizike (si lartësia mbi tokë, lartësia nën tokë, numri i kateve mbi dhe nën tokë, lloji i çatisë), me aspektet kohore (viti i ndërtimit) apo aspekti funksional (natyra e ndërtesës apo përdorimi aktual).

		
	Ndertesa mund te ndahet	Ndertesa mund te paraqitet
Ndertesa ne realitet	Ndertesa mund te ndahet ne dy PjeseNdertese A dhe B per shkak te perdorimeve te ndryshme.	Ndertesa mund te paraqitet si nje ndertese e vetme me te dyja perdorimet.
		
Ndertesa ne realitet	Ndertesa mund te ndahet ne dy PjeseNdertese A dhe B per shkak te datave te ndryshme te ndertimit.	Ndertesa mund te paraqitet si nje ndertese e vetme me date ndertimi ate me te hershmen dhe me daten me re, si date rinovimi.

Shembuj të ndarjes së ndërtesës në PjesëNdërtese bazuar në numrin e kateve mbi dhe nën tokë.



	A	B	C
Numri i kateve mbi toke	3	0	0
Numri i kateve nën toke	0	1	1

	A	B	C
Numri i kateve mbi toke.	8	0	8
Numri i kateve nen toke.	3	3	3





Shperndarja e kateve.	A	B	C
	[0,21]	[0,12], [18, 21]	[0, 21]

Shperndarja e kateve.	A	B1	B2	C
	[0,21]	[0,12]	[18, 21]	[0, 21]



Është në zgjedhje të ofruesit të të dhënave të përcaktojë se cfarë konsiderohet Ndërtesë dhe cfarë konsiderohet PjesëNdërtese (nëse ky koncept përdoret). Ky informacion duhet të ofrohet si metadatë

Më poshtë ilustrohen shembuj të kuotave referenë për lloje të ndryshme ndërtesash. Kuota mund të matet në nivele të ndryshme të ndërtesës. Kjo duhet të dokumentohet duke përdour atributin: KuotaReferencë.



Më poshtë tregohen disa shembuj për referencën e gjeometrisë horizontale:



Këto dhe vlera të tjera të parcaktuara gjenden në kod listën VleraEReferencësSëGjeometrisëHorizontale.

3.1.3.1.1. KonstruksionAbstrakt

-- Emri --
Konstruksion abstrakt

-- Përkufizimi --
Lloj objekti hapësinor abstrakt që grupon përkatësitë semantike të ndërtesave, pjesëve të ndërtesave dhe disa lloje opsionale objektesh hapësinore që mund të shtohen, në mënyrë që të sigurohet më tepër informacion për temën Ndërtesat.

-- Përshkrimi --
Llojet opsionale të objekteve hapësinore që mund ti shtohen profileve bazë përshkruhen në profilet e zgjeruara. Ato që trashëgojnë atribute nga KonstruksionAbstrakt janë Instalimet dhe KonstruksioneTëTjera.

Tipi i elementit – *featureType*

ATRIBUTET
InspireId : Identifikues **-- Emri --** Inspire Id **-- Përkufizimi --** Identifikues i jashtëm i objektit hapësinor. **-- Përshkrimi --** Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga organi përgjegjës, I cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit hapësinor, jo një identifikues i fenomenit në botë. [Detyrueshme : PO]
FillimiIJetëgjatësisë : Datë **-- Emri --** Fillimi i jetëgjatësisë **-- Përkufizimi --** Data në të cilën ky version i objektit hapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave hapësinore. [Detyrueshme : PO]
MbarimiIJetëgjatësisë : Datë Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Mbarimi i jetëgjatësisë

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky version i objektit hapësinor është zëvëndësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave hapësinore.

[Detyrueshme : PO]

DataENdërtimit : DataENgjarjes
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Data e ndërtimit

-- Përkufizimi --
Data e ndërtimit.

[Detyrueshme : PO]

DataERinovimit : DataENgjarjes
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Data e rinovimit

-- Përkufizimi --
Data e rinovimit të fundit më të rëndësishëm.

[Detyrueshme : PO]

DataEShembjes : DataENgjarjes
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Data e shembjes

-- Përkufizimi --
Data e shembjes.

[Detyrueshme : PO]

Emërtimi : EmërtimetGjeografike
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Emërtimet gjeografike

-- Përkufizimi --
Emri i konstruksionit.

-- **Përshkrimi** --
Psh: Big Ben, Kulla Eifel, Sagrada Familia.

[Detyrueshme : PO]

GjendjaEKonstruksionit : VleraEGjendjesSëKonstruksionit

-- **Emri** --
Gjendja e konstruksionit

-- **Përkufizimi** --
Statusi i konstruksionit.

-- **Përshkrimi** --
Psh: funksional, i ndërtuar, gërrmadhe.

[Detyrueshme : PO]

Kuota : Kuota
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- **Emri** --
Kuota

-- **Përkufizimi** --
Përkatësi dimensionale vertikalisht e kufizuar që konsiston në një përmasë absolute të referencuar në një sipërfaqe të mirë përcaktuar që konsiderohet si origjinë (gjeoid, niveli i detit etj).

-- **Përshkrimi** --
Burimi: përshtatur nga përkufizimi i dhënë në specifikimiet e të dhënave të temës Kuotat.

[Detyrueshme : PO]

LartësiaMbiTokë : LartësiaMbiTokë
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- **Emri** --
Lartësia mbi tokë

-- **Përkufizimi** --
Lartësia mbi tokë.

-- **Përshkrimi** --
Shënim: Lartësia mbi tokë mund të përcaktohet si diferenca midis dy kuotave (asaj në nivelin e tokës dhe kuotës më të lartë të objektit, psh çatisë).

[Detyrueshme : PO]

ReferencëEJashtme : ReferencëEJashtme
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Referencë e jashtme

-- **Përkufizimi** --
Referencë ndaj një sistemi të jashtëm informacioni i cili përmban informacion që lidhet me objektin hapësinor.

-- **Përshkrimi** --
Shembulli 1:
Referencë ndaj një grupi tjetër të dhënash hapësinore i cili përmban një tjetër pikëpamje mbi ndërtesat. Referenca e jashtme mund të përdoret për shembull për të siguruar përputhshmëri mes paraqitjeve 2D dhe 3D të të njëjtave ndërtesa.
Shembulli 2:
Referencë ndaj një regjistri banesash apo kadastre. Referenca ndaj këtij regjistri mund të mundësojë gjetjen e informacionit ligjor lidhur me ndërtesat si pronarët apo kriteret e vlerësimit (psh lloji i sistemit të ngrohjes, gatimit etj).
Shembulli 3:
Referencë ndaj sistemit të regjistrimit të lejeve të ndërtimit. Referenca ndaj lejeve të ndërtimit mund të përdoret për të gjetur informacion mbi aspektet fizike dhe kohore të ndërtesës.

[Detyrueshme : PO]

LIDHJET

Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)

Origjina: (Klasa) Adresa «featureType»

Objektivi: «voidable» ndertese (Klasa) KonstruksionAbstrakt «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- **Emri** --
Ndërtesë

-- **Përkufizimi** --
Ndërtesa të cilës i është caktuar adresa apo me të cilën adresa është e lidhur.

-- Përshkrimi --
Shënim: Një adresë mund të ketë lidhje me asnjë, një ose disa ndërtesa. Mund edhe që një,disa adresa të ndryshme të jenë të lidhura me një objekt (por kjo nuk shprehet në këto skema aplikimi)

LIDHJET
Lidhjet (drejtimi: Burimi -> Destination) Burimi: (Klasa) AerodromeNode «featureType» Objektivi: «voidable» kullaEKontrollit (Klasa) KonstruksionAbstrakt «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] -- **Emri** -- Kulla e kontrollit -- **Përkufizimi** -- Grupi i kullave të vrojtimit që i përkasin një aerodromi (aeroport/heliport).

3.1.3.1.2. NdërtesëAbstrakte

-- **Emri** --

Ndërtesë abstrakte

-- **Përkufizimi** --

Lloj objekti hapësinor abstrakt që grupon përkatësitë semantike të llojeve të objekteve hapësinore Ndërtesa dhe PjesëNdërtese.

Tipi i elementit – *featureType*

ATRIBUTET
NatyraENdërtesës : VleraENatyrësSëNdërtesës Shumëllojshmëria: [0..*] -- **Emri** -- Natyra e ndërtesës -- **Përkufizimi** -- Karakteristikë e ndërtesës që e bën atë me interes për përdorime në harta. Karakteristika mund të jetë e lidhur me aspekte fizike apo/dhe funksionale të ndërtesës. -- **Përshkrimi** -- Ky atribut fokusohet në aspektin fizik të ndërtesës megjithatë ky aspekt fizik shpesh herë shprehet përmes funksionit (psh stadium, mulli); ky atribut synon të përmbushë kryesisht qëllime lidhur me hartat dhe adreson vetëm ndërtesa specifike dhe që bien në sy. [Detyrueshme : PO]
NumriIBanesave : Integer Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --
Numri i banesave

-- **Përkufizimi** --
Numri i banesave.

-- **Përshkrimi** --
Një banesë është një njesi rezidenciale e cila konsiston në një ose disa dhoma të projektuara për nevojat e jetës së përditshme.
Shënim: Banesa konsiderohet si njësi ndërtimi rezidenciale ose, vetëm kur ndërtesa nuk ka njësi ndërtimi, ajo konsiderohet ndërtesë rezidenciale.
Shembull: një ndërtesë e vetme banimi mund të jetë e veçuar ose gjysëm e veçuar. Një bllok ndërtesash do të përmbajë një numër të shumtë banesash përcaktuar nga numri i ndërtesave individuale.

[Detyrueshme : PO]

NumriIKateveMbiTokë : Integer
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --
Numri i kateve mbi tokë

-- **Përkufizimi** --
Numri i kateve mbi tokë.

[Detyrueshme : PO]

